

## Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

A e dini se “amerikani normal” ha 24 kuarts akullore dhe 68 kuarts kokoshka çdo vit? E keni vrarë ndonjëherë mendjen të gjeni si llogariten këto gjëra? Kapitulli në vijim i kushtohet analizës së të dhënave – numrave, fakteve ose çdo lloj tjetër informacioni të matshëm.


Do të njiheni me tri mënyra për matjen e asaj që është tipike – mesorja, moda dhe mesatarja. Ja një shembull. Zëreni se u keni kërkuar 15 shokëve tuaj t’ju thonë se sa filma kanë parë gjatë muajit të kaluar. Të dhënat i organizoni pastaj në një listë.

**0, 0, 0, 0, 0, 2, 2, 2, 2, 3, 3, 3, 3, 4, 6**

- Mesorja është numri në “mes” të listës – 2.
- Moda është numri që ndeshet më shpesh – 0.
- Mesatarja është numri që përftohet duke e ndarë totalin, 30 filma, në mënyrë të barabartë midis shokëve. Në rastin konkret,  $30 \div 15$ , ose 2.

Në këtë mënyrë, mund të arrini në përfundimin se shokët tuaj kanë parë mesatarisht 2 filma në muaj.

Krahas analizës së të dhënave, rëndësi ka edhe mënyra e paraqitjes së tyre. Ju i njihni tashmë grafikët shtyllorë dhe grafikët vijorë, por në këtë kapitull do të mësoni për histogramët, diagramët pemë-degë, grafikët me shtyllë të dyfishtë, dhe diagramët vijorë. Ja një diagram vijor i të dhënave të mësipërme.



Grafikët mund të na ndihmojnë t’i pikasim rregullsitë në të dhëna dhe të nxjerrim pastaj përfundime. Çfarë duket qartë nga diagrami vijor, që nuk duket dhe aq qartë nga të dhënat e paraqitura në listë?

**Fjalor** Gjatë kapitullit, do të ndesheni me këta terma të rinj të fjalorit:

shpërndarje  
histogram  
diagram vijor

mesatare  
mesore  
modë

vlerë e përtëjme  
shtrirje  
diagram pemë-degë

### Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Gjatë javëve të ardhshme, nxënësi mund të tregojë interes për të dhënat jashtë klasës. Mund të diskutoni me të për lloje të ndryshme të dhënash që grumbullohen dhe pse veprohet kështu – për shembull blerjet në dyqane ushqimësh, anketat telefonike të opinionit, sondazhet ditën e zgjedhjeve, ose vizitat në një faqe në ueb.

